

Implementuar nga:

George Williams
Youth Association
The Official Representative of the **WORLD YMCA** in Kosovo

SITUATA E FËMIJËVE NË KOMUNËN E PEJËS



Financuar nga:



Mbështetur nga:



Autorët:

Dorina Lluka Davies

Dorina Gllogjani

Fëllanza Taraku

Vesa Vuthi

Adrian Sheremeti



Projekt i financuar nga BE i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe i zbatuar nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve KOMF.

Ky botim është prodhuar me përkrahjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e George Williams Youth Association dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim zyrtar i Bashkimit Evropian apo Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF.

PËRMBAJTJA:

Kush është organizata GWY in Kosovo	4
Hyrje	4
Metodologjia	5
Informatat personale	5
Perceptimi i fëmijëve në lidhje me të drejtat e tyre	7
Perceptimet e fëmijëve në lidhje me përdorimin e dhunës	12
Perceptimet e fëmijëve në lidhje me diskriminimin	15
Pyetje të tjera	17
Kufizimet	19
Rekomandimet	19

KUSH ËSHTË ORGANIZATA GEORGE WILLIAMS YOUTH ASSOCIATION IN KOSOVO DHE ME ÇFARË MERREMI NË KOSOVË?

George Williams
Youth Association
The Official Representative of the **WORLD YMCA** in Kosovo

George Williams Youth Association in Kosovo është organizatë jo qeveritare dhe është përfaqësuese direkte e YMCA Botës me akronim GWY. GWY është organizatë e bazuar në vlerat e vullnetarizmit, që për qëllim ka inspirimin dhe inkurajimin e lidërshiptit tek të rinjtë dhe asiston në një ambient të shëndetshëm të komunitetit.

Vizioni ynë për Kosovë është të bëhemi një organizatë e fortë dhe kredibile e cila punon në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Gjithashtu të ndërtojmë lidera të së tashmës dhe të së ardhmës duke investuar në fuqizimin e rinisë dhe gjithashtu të promovojmë paqe dhe unitet duke manifestuar diferencat dhe diversitetin e të tjerëve.

Zyra jonë nacionale për Kosovë është në Gjakovë. Për momentin punojmë në këto Komuna: Gjakovë, Junik, Pejë dhe Prishtinë, kemi më tepër se 600 përfitues direkt që janë pjestarë aktiv në rutina javore në programet tona. Në mënyrë indirekte për dy vitet e fundit mendojmë që kemi arritur rreth 40000 persona të shoqërisë sonë.

Duke e llogaritur ndikimin e pjesëmarrësve aktiv dhe vetëdijësimin e shoqërisë në bazë të fushatave dhe programeve të ndryshme.

Për momentin YMCA ndodhet në 119 shtete dhe ka mbi 58 milion pjesëmarrës aktivë çdo vit.

Hyrje

Organizata George Williams Youth Association in Kosovo (GWY) është duke e implementuar projektin "Safe Space for Children" në Komunën e Pejës. Qëllimi i këtij projekti është që të avokojmë dhe të punojmë një plan konkret në mënyrë që të sigurohemi që mbrojtja dhe mirëqenia e fëmijëve do të jetë prioritet për Komunen e Pejës. Në kuadër të këtij projekti do të dizajnojmë Planin e Veprimit për Fëmijë në Pejë për vitet 2019-2020-2021, ndërsa për dizajnimin e këtij plani do të na ndihmojnë të dhënat e dala nga ky hulumtim. Gjithashtu do të i shfrytëzojmë rekomandimet e dalura nga dy tryezat e diskutimit që do të mbahen me akterët komunalë që punojnë në këtë fushë në Komunen e Pejës. Ky projekt është i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF. Projekti "Safe Space for Children" në Komunën e Pejës ka filluar të implementohet në muajin tetor të vitit 2017. Organizata George Williams Youth Association in Kosovo ka bashkëpunim shumë të mirë edhe me Komunën e Pejës, bashkëpunim ky që ka filluar në vitin 2015 kur Komuna e Pejës ndau një zyrë për organizatën dhe i ofroi hapësirat e Qendrës Rinore për mbajtjen e aktiviteteve të organizatës GWY. Aktivitetet kryesore të organizatës GWY në Pejë janë program i Lidërshiptit dhe TenSing ku të rinjve u ofrohen trajnime të cilat ndihmojnë në socializmin e tyre, zhvillimin profesional dhe personal, fuqizimin rinor dhe nxitjen e ndërmarrësisë.

METODOLOGJIA


Rezultatet e analizuara më poshtë janë bazuar në pyetësorë me pyetje të hapura dhe të mbyllura. Numri i pjesëmarrësve ka qenë 210 fëmijë dhe zgjedhja e pjesëmarrësve ka qenë e rastësishme.

Në mënyrë të rastësishme janë zgjedhur nxënësit e 9 klasëve të Shkollave të Mesme të Ulëta “Asdreni” dhe “Lidhja e Prizrenit” në Komunën e Pejës. Klasët që kanë marrë pjesë në hulumtim kanë qenë nga paralelet 6,7 dhe 8, ndërsa për secilën paralele janë zgjedhur nga 3 klasë nga po këto shkolla.

Janë zgjedhur pikërisht këto duke qenë se janë 2 shkollat e mesme të ulëta më të mëdha sa i përket numrit të nxënësve dhe gjithashtu janë shkolla që përfshijnë nxënës nga vendbanimet urbane dhe rurale. Pjesëmarrësit në hulumtim kanë qenë nga mosha 10 deri në 14 vjeç. Realizimi dhe punimi i këtij hulumtimi ka zgjatur rreth 2 muaj.


INFORMATAT PERSONALE

GJINIA



Zgjedhja e mostrës ka qenë e rastësishme prandaj edhe ndarja në bazë të gjinisë ka qenë e rastësishme. Në grafikun e mësipërm mund të shohim që 45% e pjesëmarrësve kanë qenë vajza, 51% kanë qenë djem ndërsa 4% nuk kanë preferuar të tregojnë gjininë e tyre.

MOSHA




- 10 deri 12
- 13 deri 14
- 15

Njëra nga informatat personale në pyetësor ka qenë edhe mosha e pjesëmarrësve e cila ka qenë pyetje e mbyllur (dmth. pjesëmarrësit kanë qenë të obliguar të tregojnë moshën).

Mosha është ndarë në tri kategori në mënyrë që informatat të jenë më të sakta dhe relevante. Në grafik mund të shihet se 46% e të anketuarve kanë qenë të grup moshës 10 deri në 12 vjeç, kurse 53% të pjesëmarrësve i kanë takuar grup moshës 13 deri 14 vjeç. Në grafik shihet që vetëm 1% e pjesëmarrësve i kanë takuar grup moshës 15 vjeç.

KU JETONI?




- Qytet
- Fshat
- Nuk preferoj të tregoj

Pjesëmarrësit gjithashtu janë pyetur se ku jetojnë, prej tyre 95% jetojnë në qytet, 3% jetojnë fshat ndërsa 2% e pjesëmarrësve nuk kanë preferuar të tregojnë se ku jetojnë.

PERCEPTIMI I FËMIJËVE NË LIDHJE ME TË DREJTAT E TYRE

A KENI DËGJUAR PËR KONVENTËN PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE?



■ Po
■ Jo
■ Nuk jam i/e sigurtë


Kur fëmijët janë pyetur se a kanë dëgjuar ndonjëherë për Konventën për të Drejtat e Fëmijëve 64% e pjesëmarrësve kanë treguar që po kanë dëgjuar, 25% prej tyre nuk kanë dëgjuar asnjëherë ndërsa 11% e fëmijëve nuk kanë qenë të sigurtë se a kanë dëgjuar ndonjëherë për këtë Konventë.

Megjithatë duhet të ceket që shumë prej tyre kanë treguar që nuk e dijnë se çka përmban ajo.

Në pyetjen se cilat të drejta të tyre fëmijët i njohin shumica prej tyre përkatësisht 72 fëmijë kanë treguar që e njohin të drejtën e shkollimit, ndërsa të tjerët kanë treguar që njohin edhe të drejta të tjera si e drejta për të u shprehur lirshëm, e drejta që të gjithë fëmijët të jenë të barabartë, e drejta e emrit, e drejta për të jetuar në një ambient të sigurtë me prindërit, e drejta e lojës, e drejta e të jetuarit të lirë.

65 fëmijë kanë thënë që njohin të drejta të tjera por që nuk e kanë cekur se cilat prej tyre, ndërsa 40 fëmijë kanë treguar që nuk njohin asnjë të drejtë të tyre.

CILAT TË DREJTA TË FËMIJËVE JU I NJIHNI?





1. Shtetet Palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmedura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjor.




Neni 1

KONVENTA MBI TË DREJTAT E FËMIJËS


Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989

KUSH ËSHTË I OBLIGUAR QË TË SIGUROJË TË DREJTAT E FËMIJËVE?




Fëmijët janë pyetur se sipas tyre kush është i obliguar që ti sigurojë të drejtat e fëmijëve. Në këtë pyetje fëmijët janë përgjigjur kështu: 140 mendojnë që shteti duhet ti sigurojë të drejtat e fëmijëve, 85 mendojnë që familja, 42 fëmijë mendojnë që shkolla duhet ti sigurojë të drejtat e fëmijëve, 38 fëmijë mendojnë që OJQ-të janë ato që duhet të i sigurojnë këto të drejtat dhe vetëm 2 fëmijë mendojnë që edhe të tjerët duhet ti sigurojnë të drejtat e fëmijëve.

A KENI NJOHURI A ËSHTË E DREJTA E ARSIMIT E GARANTUAR NË KUSHTETUTEN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS?



Siç mund të shihet nga grafiku më lartë 51% e pjesëmarrësve e dijnë që e drejta e arsimimit është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, 44% e fëmijëve pjesëmarrës nuk e dijnë se a është kjo e drejtë e garantuar ndërsa 5% mendojnë që e drejta e arsimit nuk është e garantuar.


**SIPAS JUSH FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA
A KANË TË DREJTË TË SHKOLLIMIT NË KLASË TË
RREGULLTA?**



Grafiku më lart tregon për mendimet e fëmijëve pjesëmarrës në lidhje me shkollimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. 82% e pjesëmarrësve mendojnë që fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të shkollimit në klasë të rregullta, 9% mendojnë që nuk kanë të drejtë të shkollohen në klasa të rregullta ndërsa 9% nuk e dinë se a kanë të drejtë të shkollimit në klasa të rregullta fëmijët me aftësi të kufizuara.


Kjo tregon që 18% e pjesëmarrësve nuk janë pozitiv për bashkangjitjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasë të rregullta bashkë më ata.

**A MENDONI QË RESPEKTOHET MENDIMI JU AJ
NGA ANA E MËSIMDHËNËSIT?**



Në grafikon më lart mund të shohim që 58% e fëmijëve pjesëmarrës mendojnë se mendimi i tyre respektohet nga ana e mësimitdhënës, 35% mendojnë që ndonjëherë respektohet ndërsa 7% mendojnë që mësimitdhënës nuk i respektojnë mendimet e tyre fare.


**ÇFARË MENDONI JU CILAT TË DREJTA NUK RESPEKTOHEN NË
FAMILJET TUAJA?**



Fëmijët pjesëmarrës janë pyetur se çfarë mendojnë ata, cilat të drejta të tyre nuk respektohen në familje. Ata janë përgjigjur kështu: 40% fëmijë tregojnë që në familjen e tyre respektohen të gjitha të drejtat, ndërsa të tjerët tregojnë që e drejta e privatësisë, e drejta e mendimit personal, e drejta e lirisë së zgjedhjes dhe e drejta e informimit janë ato që më së paku respektohen në familjet e tyre.

Fëmijët kanë nevojë për modele jo për kritika


KU APO KUJT I DREJTOHENI KUR JU SHKELEN TË DREJTAT TUAJA NË FAMILJE?



Në këtë grafik mund të shohim që 34 % e fëmijëve pjesëmarrës i'u drejtohen prindërve kur ju shkelen të drejtat e tyre në familje, 27% i drejtohen familjes pra edhe anëtarëve të tjerë përveç prindërve, 12% i drejtohen drejtorit apo mësimdhënësit, 11% i drejtohen dikujt tjetër por nuk kanë preferuar të tregojnë se kujt, 10% nuk e dijnë se kujt duhet të drejtohen ndërsa 6% e fëmijëve kanë thënë që nuk i tregojnë askujt kur i'u shkelen të drejtat e tyre në familje.

Perceptimet e fëmijëve në lidhje me përdorimin e dhunës


TË RRITURIT PËRDORIN MËNYRA TË CAKTUARA PËR T'UA MËSUAR FËMIJËVE SJELLJET E DUHURA OSE PËR TA ADRESUAR NJË PROBLEM NË SJELLJE. JU LUTEM NA TREGONI NËSE DIKUSH NË FAMILJEN TUAJ E KA PËRDORUR KËTË METODË GJATË MUAJVE TË KALUAR¹



Fëmijët janë pyetur gjithashtu nëse dikush nga familja e tyre gjatë muajve të kaluar ka përdorur ndonjë formë të dhunës fizike apo psikike. Në këtë pyetje fëmijët kanë pasur mundësi të shumëfishta të përgjigjes për arsye edhe të natyrës së ndjeshme të çështjes. Të gjithë fëmijët kanë zgjedhur më shumë se një opsion të përgjigjes, kjo gjë tregon që fëmijët i shtrohen formave të ndryshme të dhunës fizike apo psikike në familje. Në rezultatet e mësipërme mund të shohim që 22% e fëmijëve të paktën një herë gjatë muajve të fundit i'u është sqaruar sjellja e gabuar nga dikush në familje, 17% prej pjesëmarrësve i'u është ngritur zëri/bërtitur në familje, 13% prej fëmijëve pjesëmarrës i janë hequr privilegjet si formë e ndëshkimit në familje, 11% e fëmijëve pjesëmarrës të paktën një herë gjatë muajve të fundit janë quajtur të marrë, përtac/e ose me ndonjë emër tjetër nga dikush në familje, 9% e fëmijëve janë shkundur fizikisht të paktën një herë në familjen e tyre. 14% e fëmijëve pjesëmarrës gjatë muajve të fundit kanë treguar që kanë përjetuar forma të ndryshme të dhunës fizike si goditje me rrip, shkop, shuplakë në fytyrë, kokë ose vesh, janë goditur në duar, krahë ose këmbë, ose janë rrahur pa u ndalur.


¹Pyetjet në lidhje me dhunën janë bazuar në pyetësorin e MICS të zhvilluar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

A TË KA NDODHUR QË TI TË PËRDORËSH
DHUNË NDAJ DIKUJT NË FAMILJEN TËNDE?




Në grafikun më lart mund të shohim që edhe fëmijët pjesëmarrës janë ata që përdorin dhunë familjet e tyre, përkatesisht 80% e tyre kanë përdorur ndërsa vetëm 20% nuk ka përdorur asnjëherë. Vlen të ceket se shumica e fëmijëve kanë treguar se kanë rrahur apo ngacmuar vëllaun apo motrën e tyre.

NDONJËHERË MËSIMDHËNËSIT PËRDORIN MËNYRA TË CAKTUARA PËR T'UA MËSUAR
NXËNËSVE SJELLJET E DUHURA OSE PËR TA ADRESUAR NJË PROBLEM NË SJELLJE.
JU LUTEM NA TREGONI NËSE DIKUSH NË SHKOLLË E KA PËRDORUR KËTË METODË GJATË
MUAJVE TË KALUAR¹



Fëmijët janë pyetur gjithashtu nëse dikush në shkollën e tyre gjatë muajve të kaluar ka përdorur ndonjë formë të dhunës fizike apo psikike. Edhe në këtë pyetje fëmijët kanë pasur mundësi të shumëfishta të përgjigjes. Të gjithë fëmijët kanë zgjedhur më shumë se një opsion të përgjigjes gjë që tregon që fëmijët përballen me forma të ndryshme të dhunës në shkollë. Në rezultatet e mësipërme mund të shohim që 24% e fëmijëve të paktën një herë gjatë muajve të fundit i'u është sqaruar sjellja e gabuar nga dikush në shkollën e tyre, 19% të fëmijëve pjesëmarrës i'u është ngritur zëri/bërtitur në shkollë, 12% të fëmijëve janë quajtur të marrë, përtac/e ose me ndonjë emër tjetër, 10% prej fëmijëve pjesëmarrës i janë hequr privilegjet si formë e ndëshkimit në shkollë, 10% të fëmijëve të paktën një herë janë shkundur fizikisht nga dikush në shkollën e tyre, 8% të fëmijëve pjesëmarrës të paktën një herë i është dhënë të bëjnë diçka tjetër në shkollën e tyre si formë e ndëshkimit për një sjellje që është perceptuar si jo e duhur. Ndërsa 17% e fëmijëve pjesëmarrës gjatë muajve të fundit kanë treguar që kanë përjetuar forma të ndryshme të dhunës fizike në ambiente të shkollës së tyre. Dhuna është manifestuar në forma të ndryshme si goditje me rrip, shkop, shuplakë në fytyrë, kokë ose vesh, janë goditur në duar, krahë ose këmbë, ose janë rrahur pa u ndalur


A NJIHNI JU NDOJË FËMIJË TË CILIN MËSIMDHËNËSI E KA NGACMUAR, FYER APO RRAHUR?




Në mënyrë që fëmijët të jenë më specifik për dhunën që përdoret në shkollë dhe që ata kanë qenë dëshmitarë fëmijët janë pyetur edhe për raste të veçanta. Megjithatë 65% kanë treguar që nuk njohin ndonjë fëmijë ndaj të cilit është përdorur dhunë apo ngacmuar ndërsa 35% kanë thënë që njohin nxënës që kanë përjetuar formë të tillë të dhunës.

Në mënyrë që të shohim se çfarë mendojnë fëmijët pjesëmarrës në lidhje me dhunën në përgjithësi ata janë pyetur se sipas mendimit të tyre a mund të tolerohet dhuna. 76% e fëmijëve pjesëmarrës mendojnë që dhuna nuk mund të tolerohet, 10% mendojnë që ndonjëherë edhe mund të tolerohet ndërsa 14% nuk kanë njohuri në lidhje me këtë çështje.

A MENDONI JU QË DHUNA MUND TË TOLEROHET?




KU I TREGONI RASTET E DHUNËS QË I SHIKONI?



51 fëmijë pjesëmarrës i tregojnë në familje rastet e dhunës që i shohin, 41 i tregojnë në shkollë përkatësisht drejtorit apo mësimdhënësit kujdestarë, 30 fëmijë i'u tregojnë vetëm prindërve, 53 fëmijë i'u tregojnë të tjerëve dhe nuk kanë preferuar të tregojnë se kujt. Pjesa tjetër përkatësisht 30 fëmijë nuk i tregojnë askund ndërsa 8 fëmijë nuk e dinë se ku duhet të i tregojnë këto raste,


PERCEPTIMET E FËMIJËVE PJESËMARRËS NË LIDHJE ME DISKRIMINIMIN

A JENI NDJERË NDOJËHERË JU TË DISKRIMINUAR?




41% e fëmijëve pjesëmarrës në këtë hulumtim kanë treguar që janë ndjerë të diskriminuar duke e përcaktuar se sa shpesh ka ndodh ky diskriminim, 59 kanë treguar që nuk janë ndjerë asnjëherë të diskriminuar.

NËSE PO NË ÇFARË AMBIENTI JENI NDJERË TË DISKRIMINUAR?



Prej 41% të fëmijëve që kanë treguar që janë ndjerë të diskriminuar shumica prej tyre kanë treguar që kjo ka ndodhur në ambiente të shkollës përkatësisht 45 fëmijë, ndërsa pjesa tjetër kanë treguar që janë ndjerë në shtëpi, lagje apo edhe vende të tjera por nuk kanë preferuar të tregojnë se ku.

NËSE PO PËR ÇKA JENI NDJERË TË DISKRIMINUAR?




Fëmijët pjesëmarrës më së shumti janë ndjerë të diskriminuar për shkak të moshës së tyre saktësisht 26%, pjesa tjetër kanë përmendur arsye si përkatësia etnike, gjinia, statusi social apo dhe përkatësia fetare. 37% kanë përmendur arsye të tjera dhe nuk kanë preferuar të tregojnë se cilat janë ato.

diskriminimi

Pyetje të tjera


SA NDJEHENI TË SIGURTË NË AMBIENTIN NË TË CILIN JETONI?



Në mënyrë që të shohim perceptimet dhe mendimet e fëmijëve pjesëmarrës për situatën e tyre jashtë ambientit shkollor apo familjarë ata janë pyetur edhe në lidhje me atë se sa ndjehen të sigurtë në ambientin në të cilin jetojnë.

72 % e pjesëmarrësve janë treguar pozitiv në lidhje me sigurinë në ambientin ku ata jetojnë, ndërsa 28% kanë treguar që ndjehen pak ose aspak të sigurtë. Këtu vlen të ceket se fëmijët e kanë përcaktuar rrezikun nga qentë endacak si arsye për të mos u ndjerë të sigurtë ku ata jetojnë.


A JENI JU TË PËRFSHIRË NË NDONJË AKTIVITET JASHTËSHKOLLORË?



Duke i vlerësuar si shumë të rëndësishme për mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijëve angazhimet e tyre në aktivitete të tjera jashtë-shkollore, pjesëmarrësit janë pyetur edhe rreth këtyre angazhimeve.

74% prej fëmijëve pjesëmarrës nuk kanë marrë pjesë kurrë në ndonjë aktivitet jashtë shkollës, 14% kanë marrë pjesë ndonjëherë ndërsa vetëm 12% marrin pjesë vazhdimisht në aktivitete jashtë-shkollore.

A MENDONI JU QË FËMIJËT KANË FUQI PËR TË BËRË NDRYSHIME NË KOMUNITET?



Në mënyrë që të shohim se sa fëmijët ndjehen të rëndësishëm dhe të fuqishëm në ambientin e tyre fëmijët pjesëmarrës janë pyetur edhe se sa mendojnë ata që kanë fuqi të bëjnë ndryshime pozitive në komunitetin e tyre. Shumica e fëmijëve pjesëmarrës apo 66% janë shprehur pozitivisht për këtë çështje. Megjithatë numri i atyre që ndjehen të pafuqishëm për të bërë ndonjë ndryshim është gjithashtu i lartë përkatësisht 25%. Në fund të pyetësorit është kërkuar nga fëmijët që të japin rekomandime se si ne të gjithë së bashku do të mund të ndryshonim situatën e tanishme të fëmijëve në Kosovë. Idetë e fëmijëve kanë qenë nga më të ndryshmet dhe disa prej tyre janë përmbledhur në këto dhjetë rekomandime:

- Duhet të respektojmë të drejtat e tjetrit dhe të mbrojmë të drejtat tona.
- Duhet të mos diskriminojmë dhe të respektojmë njëri – tjetrin.
- Duhet të kemi sistemin e arsimit më të fortë.
- Të mos përdorim dhunë, në të kundërtën të dënohen personat që përdorin dhunë.
- Të ngremë zërin për çdo të padrejtë që shohim që është duke ndodhur.
- Organizatat duhet të punojnë më shumë që të promovojnë barazinë. Gjithashtu fëmijët duhet të marrin pjesë më shumë në organizata joqeveritare.
- Duhet që të dëgjojmë më shumë mendimet dhe idetë e fëmijëve. Gjithashtu duhet ti i inkurajojmë fëmijët që të shprehen lirshëm.
- Duhet ti ndihmojmë fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe atyre me probleme sociale. Gjithashtu duhet të respektojmë fetë e njëri – tjetrit.
- Duhet të mësohemi të respektojmë njëri – tjetrin pavarësisht gjinisë apo statusit social.
- Duhet ti ofrojmë të gjithë fëmijëve ambient të sigurtë, p.sh . pa qenë endacakë.

Kufizimet

Duke pasur parasysh se ky studim është vetëm studim pilot, ka shumë mangësi dhe kufizime që mund të përmirësohen, megjithatë, nëse studimi ri-niset në një shkallë të madhe. Problemi i parë vjen nga madhësia e mostrës vetë, e cila ishte relativisht e vogël, duke pasur parasysh numrin e fëmijëve të Pejës dhe personat të cilët ndjekin institucionet arsimore (në rastin tonë shkollat fillore dhe të mesme të ulët) në Pejë. Është e vështirë për të përgjithësuar gjetjet e studimit, kur vetëm 210 persona janë anketuar. Megjithatë, duke pasur parasysh se ky është vetëm një studim pilot, na jep një ide të mirë se si duket kjo fushë, dhe se si ne duhet të vazhdojmë në të ardhmen; ky hulumtim i jep studiuesit një ide bazë të asaj se si është situata dhe cilat probleme janë më të mëdha.

Rekomandime

- Në këtë hulumtim shumica e fëmijëve kanë treguar që kanë dëgjuar për Konventën e të Drejtave të Fëmijëve por kur janë pyetur se çfarë përmban nuk kanë pasur njohuri. Prandaj konsiderojmë që fëmijët duhet të informohen ende në lidhje me këtë Konventë.
- Fëmijët pjesëmarrës kanë pasur shumë pak njohuri në lidhje me të drejtat e fëmijëve që janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Prandaj konsiderojmë që Organizatat e Shoqërisë Civile që punojnë për këtë çështje duhet të punojnë ende në këtë drejtim, duke mos e anashkaluar këtu edhe përgjegjësinë e shkollës në lidhje me këtë.
- Shumica e fëmijëve pjesëmarrës kanë treguar që në familjet e tyre nuk përdoret dhunë megjithatë kur janë pyetur se a ka pasur rast kur ata vet kanë përdorur dhunë shumica kanë treguar që po e kanë rrahur apo ngacmuar të paktën një herë motrën apo vëllaun. Kjo tregon që shumë fëmijë nuk kanë njohuri për llojet e ndryshme të dhunës që hezitojnë ta raportojnë atë, që i konsiderojnë ato të justifikueshme deri në një masë të caktuar apo që hipotetizojnë kanë marrë modele të tilla të ushtrimit të formave të ndryshme të dhunës nga mjedisi familjar. Kjo është e evidente pasi përgjigjet e fëmijëve të anketuar dhe rezultatet e dala prej tyre bien ndesh me të dhënat zyrtare të Agjencisë së Statistikave – ASK² të publikuara në vitin 2014, ku rezulton se 61.4 për qind e fëmijëve të anketuar deri në moshën 14 vjeç, kanë deklaruar se kishin pësuar nga dhuna psikike apo ndëshkimi fizik nga anëtarët e ekonomisë familjare gjatë muajit të fundit nga data e intervistimit. Prandaj rekomandohet që Organizatat e Shoqërisë Civile që punojnë në këtë drejtim duhet të punojnë më shumë në informimin e fëmijëve në lidhje me llojet e ndryshme të dhunës. Kjo gjë duhet të bëhet në bashkëpunim me akterët komunal.
- Hulumtimi tregon që një pjesë e madhe e fëmijëve nuk i raportojnë apo nuk e dijnë se ku duhet të i raportojnë rastet e dhunës. Prandaj rekomandohet që fëmijëve të ju ofrohen platforma apo mekanizma raportues më lehtë të qasshme për të raportuar këto raste.
- Diskriminimi vazhdon të jetë i pranishëm, kjo ndodhë më së shumti në ambientet shkollore. Prandaj rekomandohet që shkolla në bashkëpunim me prindërit të punojë më shumë në këtë aspekt në edukimin e fëmijëve për të pranuar njëri-tjetrin pa marrë parasysh dallimet e tyre.
- Sipas këtyre rezultateve shumica e fëmijëve nuk janë përfshirë asnjëherë në aktivitete jashtë – shkollore dhe duke e marrë në konsideratë se sa e rëndësishme është aktivizimi i tyre në këto aktivitete, rekomandojmë që komuna dhe OJQ-të që punojnë për fëmijët të ofrojnë më shumë programe të edukimit jo – formal.
- Ndërkohë që rezultatet e këtij studimi janë shumë interesante dhe premtuese, ende mbetet një studim pilot. Një studim më i madh me më shumë pjesëmarrës, një proces më rigoroz i përzgjedhjes mund të çojë në rezultate më të thella dhe veprime të cilat mund të informojnë politikën. Ne rekomandojmë ky studim i vogël eksperimental të përshkallëzohet dhe kjo mund të çojë në dëshmi të bazuara për politikë-bërje.
- Në tërësi të analizimit të fenomenit të dhunës ndaj fëmijëve dhe problematikave që rrjedhin nga mosadresimi i duhur i tij, një plan veprimi komunal për të drejtat e fëmijëve rezulton të jetë i domosdoshëm për të adresuar çështjet kryesore të komunës në drejtim të të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së tyre. Plani do të përcaktonte nevojat që komuna ka në këtë drejtim, prioritetet për ndërhyrje dhe do të ishte një mjet domethënës në implementimin e mëtejshëm të aktiviteteve për të garantuar se komuna e Pejës i respekton dhe i mbron të drejtat e fëmijëve.

²Agjencia e Statistikave të Kosovës; <http://ask.rks-gov.net/media/1873/anketa-e-grupimeve-te-treguesve-te-shumefishte-ne-republiken-e-kosoves-2013-2014-gjetjet-kryesore.pdf>



Projekt i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



Zbatuar nga koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë-KOMF

George Williams Youth Association
The Official Representative of the ^{WORLD}YMCA in Kosovo